**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1814/3 Prot

Rrëshen më, 23 . 06 . 2025

# V E N D I M

**Nr. 45 datë 19. 06. 2025**
**PËR**
**"PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE",**
**BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 24.01.2025, "Për miratimin e buxhetit 2025", VKB nr. 115, datë 27.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", *relacionin nr. 1814/1 prot, datë 26. 05. 2025, "Mbi vlerësimin ekonomik - social të familjes të Z. Kreshnik Frrok Sulejmani", nga sektori i shërbimit social të bashkisë,* së bashku me projektin e Kryetarit Bashkisë, *shqyrtimin e miratimin në mbledhjen e datës 30.05.2025, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit,* për t'a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

## V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, *në shumën **100 000** (njëqind mijë) lekë*, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;

- T'i akordojë ndihmë financiare, Z. Kreshnik Frrok Sulejmani me ID; I30222048M, fshati Troje, njësia administrative Kthellë, për kushte të vështira jetese

   a. **Paksim:** Fondi rezervë;(A1133 00 2133001 01 V491AAA...604) në vlerën;.....**100 000** lekë

   b. **Shtohet:** Pagesë;(AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.............**100 000** lekë

2. Pagesa të kalojë me bordero, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat)

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!*

**S E K R E T A R**
**Gaspër TOPOLLAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

**K R Y E T A R**
**Aleksandër PICAKU**

ADRESA: SHESHI "ABATI DOCI" RRËSHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

**BASHKIA MIRDITË**

**KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË**

**P/V E N D I M**

**Nr**1814**/Prot** /2

**Datë**27.05**/2025**

**Nr.** 49 **date.** 27.05 **.2025**

"PËR PERDORIM FOND REZERVE "

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", 115/2024, "Per buxhetin e vitit 2025" "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit 2025", ,ne VKB nr.115 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", në relacionin, nr.1814 prot, datë.26.05.2025, "Mbi vlesimin e situates financiare dhe sociale te z.Kreshnik Sulejmani", e sektorit të shërbimit social, Bashkia Mirditë, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkise;

**V E N D O S I:**

***I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 100000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshte;***

1.Të japë ndihmë financiare familjes së z.Kreshnik Sulejmani, banues fshatin Troje, NJA Kthelle, për kushtet të vështira jetese.

**a-Paksim**:fondi rezervë ( AI133 00 2133001 01 V491AAA..604) për shumën ***100000 lekë***

***b-Shtohet*** (AA133 00 2133001 01 V111AAA......606) për shumën ***100000 lekë***

.2.Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen .

***II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori e finances dhe buxhetit.***

***III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.***

**SEKRETARI**
**Gaspër TOPOLLAJ**

**KRYETARI**
**Aleksander PICAKU**

**Paraqiten projektin**

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

Dr.Juridike, prok, protokoll: M.Doda

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

**ME DELEGIM KOMPETENCASH**
**NEN/KRYETARI**
**GJERGJ PRENGA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.a

Financa

# BASHKIA MIRDITË

## AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE

Nr. 1814/1 Prot. Rrëshen, më 26.05.2025

**Lënda:** Relacion

**Drejtuar:** Drejtorisë së Financës së Bashkisë Mirditë

Lidhur me kërkesën e ardhur në Bashkinë Mirditë, me nr. prot. 1814, të datës 06.05.2025, e drejtuar nga kryetari i fshatit z. Gjevalin Sulejmani, në cilësinë e kryeplakut të fshatit, **për mbështetje financiare nga Bashkia Mirditë për familjen e z.Kreshnik Sulejmani**, i datëlindjes 22.02.1983, me NID I30222048M ku bashkëngjitur është edhe kërkesa e z.Kreshnik, e datës 02.05.2025, po ju japim relacionin si më poshtë:

**Të dhënat e familjes:**

- **Numri i anëtarëve:** 5 (gjyshi, dy prindër dhe katër fëmijë)
- **Vendbanimi:** Fshati Troje, Njësia Administrative Kthellë, Bashkia Mirditë

Familja në fjalë përbëhet nga 5 anëtarë dhe jeton në kushte të vështira ekonomike. Ata përfitojnë ndihmë ekonomike mujore në shumën 4,792 lekë, një shumë tejet e pamjaftueshme për të mbuluar nevojat bazë të jetesës. Njëri nga fëmijët e familjes, djali i tyre, vuan nga probleme të rënda në zemër dhe deri më tani është operuar katër herë, gjë që kërkon trajtim të vazhdueshëm mjekësor dhe mbështetje të vazhdueshme financiare. Fëmija në fjalë trajtohet me Kemp, ku përfiton shumën prej 11 652 lekë, shumë e pamjaftueshme për tëë mbuluar nevojat e shumta shëndetësore, që ky fëmijë ka.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

Në certifikatën familjare janë të regjistruar katër anëtarë, por me ta jeton edhe gjyshi, i cili merr një pension minimal prej 14.000 lekësh në muaj. Edhe kjo shumë është e pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e tij personale, përfshirë ilaçet dhe ushqimin, dhe aq më tepër për të kontribuar në nevojat e përbashkëta të familjes. Kjo familje përballet çdo ditë me mungesë të mjeteve financiare për të përmbushur nevojat elementare të jetesës, përfshirë ushqimin, kujdesin shëndetësor dhe trajtimin mjekësor të djalit të sëmurë. Situata e tyre kërkon vëmendje dhe mbështetje të menjëhershme.

Duke marrë në konsideratë situatën e rëndë të kësaj familjeje, si Shërbim Social propozojmë **dhënien e një ndihme financiare sipas mundësive për këtë familje**, për të lehtësuar sadopak vështirësitë e tyre të menjëhershme.

Konceptoi: Adela Gjikola
Miratoi: Drejtori Aurel Çupi
Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni